Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-726 Datë: 30.07.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.07.2026 merr:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe Validohet** *"KORABI PURATOS"* *me adresë:* Llapnasellë, Çagllavicë, p.n. Kosovë për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 30.07.2026 deri 29.07.2029, për kualifikimin: "Kuzhinier" me kualifikimet e bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   1.1. **Kuzhinier,** Niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve me numër total të kredive 18, kualifikim i bazuar në: **Kualifikme Kombëtare Profesionale (D).** Për kualifikimin e plotë miratohen 7 grupe në vit, me nga 15 kandidatë për grup, që përbëjnë gjithsej deri në 105 kandidatë në vit. Për certifikimin modular miratohen 12 grupe në vit, me nga 15 kandidatë për grup, duke synuar certifikimin e deri në 180 kandidatëve në vit.

2. **Riakreditohet dhe Rivalidohet** *"KORABI PURATOS"* me adresë: Llapnasellë, Çagllavicë, p.n. Kosovë për periudhën (5) vjeçare 05.08.2025 deri 04.08.2030, duke llogaritur periudhën nga përfundimi i riakreditimit të fundit sipas vendimit të KD AKK, për kualifikimin "Ndihmës Kuzhinier" me kualifikimet e bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   2.1. **Ndihmës Kuzhinier,** Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve me numër total të kredive 10, kualifikim i bazuar në: **Kualifikime Kombëtare Profesionale (D).** Për kualifikimin e plotë miratohen 5 grupe në vit, me nga 15 kandidatë për grup, që përbëjnë gjithsej deri në 75 kandidatë në vit. Për certifikimin modular miratohen 12 grupe në vit, me nga 15 kandidatë për grup, duke synuar certifikimin e deri në 180 kandidatëve në vit.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së *"KORABI PURATOS"* të parashtruar në AKK, për akreditim/validim dhe për riakreditim/rivalidim për: Qendra Inovative Korabi Puratos për kualifikimet: **"Kuzhinier" dhe "Ndihmes Kuzhinier".** Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimin si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjeve së aplikimit më: 29.05.2026 për kualifikimin: **"Kuzhinier"** Niveli IV dhe **"Ndihmës Kuzhinier"** Niveli III, ndërsa vizita është realizuar me datën 01.06.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 22.06.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 30.07.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese. AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASH Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Këshilli Drejtues i AKK-së gjatë vendimmarrjes për riakreditim ka marr parasysh faktin se institucioni kishte aplikuar brenda afatit ligjor për riakreditimin e kualifikimit si dhe kohën e shqyrtimit të dosjes së aplikimit, nga momenti i dorëzimit të kërkesës.
Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. "KORABI PURATOS"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar KD së AKK